

VENDIM
Nr. 424, datë 11.7.2018
PËR SUBVENCIONIMIN E DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJTARISË¹
(Ndryshuar me VKM nr. 588, datë 9.10.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 70/2016, “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë për një periudhë njëvjeçare, në masën 35 552 000 (tridhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.
2. *Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.*
3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

¹ VKM nr. 424, datë 11.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 104, datë 16 korrik 2018.
VKM nr. 588, datë 9.10.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 147, datë 16 tetor 2018.